



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE SOCIALE
DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL

Nr. prot. _____

Tiranë _____, 2019

Lënda: Kthim përgjigje

Z. _____

Rruga _____

Njësia Administrative Nr. _____

Tiranë

I nderuar z. _____


Në përgjigje të kërkesës suaj Nr. _____, datë _____, Drejtoria e Strehimit Social ju bën me dije se:

1. Bazuar në nenin 77, pika 10 parashikon se programet që janë në proces në zbatim të ligjit Nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", si dhe ato që do të zbatohen me fondet e planifikuara për vitin 2018 dhe 2019, do të trajtohen sipas dispozitave të ligjit Nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
2. Programi që aktualisht po zbatohet në Bashkinë e Tiranës është Bonusi i Strehimit. Gjithashtu Bashkia po punon për të përditësuar praktikën për programet e strehimit me ndryshimet e reja ligjore, përkatësisht ligji 22/2018 "Për strehimin social" dhe aktet nënligjore për zbatim të tij.
3. Drejtoria e Strehimit Social shpalli si përfituese në fazën e parë (plotësimi i formularit të strehimit) 160 aplikime, nga të cilët 155 aplikime u njoftuan për vazhdimin e fazës së dytë në bazë të shpalljes së fituesve të fazës së parë (njoftim Nr.39154 datë 17.10.2019).
4. Në muajin Tetor është miratuar nga Këshilli Bashkiak Vendimi numër 118 datë 25.10.2019 me 38 përfitues për programin Bonus Strehimi. Të gjithë aplikimet e familjeve/individëve të cilët kanë dorëzuar dokumentacion të plotë janë vendosur në dispozicion të Komisionit të Strehimit dhe janë shqyrtuar prej tij sipas vendimit Këshillit Bashkiak Nr. 91, datë 26.07.2018, për zbatimin e udhëzuesit operacional "Mbi përfitimin e bonusit të strehimit në Bashkinë Tiranë".

Banesat Sociale janë shpërndarë me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 28 datë 13.08.2015 dhe Vendim Nr. 44 datë 06.07.2016. Me Vendim të Këshillit Bashkiak është caktuar Drejtoria e Punëtoreve Nr. 3 si Ent Menaxhues për Banesat Sociale me Qira.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



Anisa Subashi